

Rregullore për menaxhimin dhe administrimin e produkteve



BASHKIA KORÇË

RREGULLORE PËR MENAXHIMIN DHE ADMINISTRIMIN E BANKËS USHQIMORE, VESHMBATHJEVE, PRODUKTEVE HIGJENOSANITARE DHE MJETEVE DIDAKTIKE

Në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet shoqatës Nisma për Ndryshim Shoqëror ARSIS dhe Bashkisë Korçë e lidhur me datë 13.07.2021 me nr.prot 6013 dhe nr.101 prot,(NISMA) dt.15.07.2021 për zbatimin e projektit “Qendra e Shërbimeve Mbështetëse për Fëmijën dhe Familjen me bazë komunitare” (Parandalimi i institucionalizimit dhe deinstitutionalizimi i fëmijëve nga Institucionet e Përkujdesit Shoqëror) me mbështetje të Fondit Social (2021-2023), ekipi i Nisma ARSIS ka hartuar dokumentin për procedurat e menaxhimit dhe administrimit të bankës ushqimore, veshmbathjeve, produkteve higjenosanitare dhe mjeteve didaktike.

Hartimi i dokumentit bazohet në nenin 4 të marrëveshjes dhe në zbatim të aktivitetit “hartimi i protokolleve, procedurave dhe manualeve të shërbimit, përfshirë dhe mekanizmat e llogaridhënies”

SHMFF ndjek të gjitha procedurat e prokurimit të artikujve ushqimor, higjenosanitare dhe veshmbathje në përputhje me zërat buxhetorë të miratuar sipas procedurave të rregullta të prokurimit në bashkëpunim me drejtorinë përkatëse në Bashkinë Korçë.

Më poshtë sugjerohen disa udhëzime të cilat rekomandohen të mbahen në konsideratë nga ekipi i SHMFF-së.

1. Koordinator i SHMFF-së duhet të përcaktojë një person përgjegjës nga stafi i cili do të administrojë bankën e produkteve ushqimore, higjenosanitare dhe të veshjeve. Personat e tjerë nuk lejohen të futen në mjediset e brendshme të magazinimit pa miratimin e stafit përgjegjës.
2. Personi përgjegjës mban inventarin për çdo produkt që hyn dhe del nga magazinat përkatëse duke plotësuar hyrjet dhe daljet nga magazina.
3. Në mjediset e SHMFF-së duhet të jetë një mjedis i dedikuar për mbledhjen dhe ruajtjen e produkteve ushqimore, higjenosanitare dhe veshmbathjeve.
4. Produktet ushqimore duhet të jenë në një mjedis më vetë nga produktet higjenosanitare, veshmbathjet dhe materialet didaktike.
5. Për produktet ushqimore duhet të kontrollohen datat e skandencës në momentin e magazinimit dhe para shpërndarjes.
6. Çdo produkt ushqimor që do të shpërndahet duhet që të kontrollohet dhe të ruhet në një paketim të sigurt dhe të përshtatshëm për ushqimin. Kjo do të ndihmojë në ofrimin e sigurisë ushqimore, do të mbrojë nga ndotësit kimikë ose mikrobet në mënyrë që të mos transferohen në ushqim dhe të ruhet cilësia.
7. Çdo mbajtës ushqimi (raftet, dollape) ose paketim për ruajtjen e ushqimit duhet të mbahet pastër ndërmjet përdorimit për të parandaluar përhapjen e mikrobeve.
8. Personi përgjegjës për magazinimin e produkteve duhet të sigurohet që produktet higjenosanitare nuk janë të hapura/të dëmtuara.

Projekti: “Qendra e Shërbimeve Mbështetëse për Fëmijën dhe Familjen me bazë komunitare” (Parandalimi i institucionalizimit dhe deinstitutionalizimi i fëmijëve nga Institucionet e Përkujdesit Shoqëror)
Fondi Social 2021-2023 Bashkia Korçë – Nisma për Ndryshim Shoqëror ARSIS



BASHKIA KORÇË

9. Për produktet higjienike si amoniaku, zbardhues të ndryshëm, acide për pastrim, duhet të sigurohet që përfituesit t'i jepen edhe doreza për përdorimin e sigurtë të tyre.
10. Veshmbathjet duhet të jenë të ndara sipas moshës dhe stinëve.
11. Veshmbathjet duhet të ruhen në mënyrë të rregullt që aksesit i personit përgjegjës për gjetjen e veshmbathjeve të duhura të jetë sa më i lehtë.
12. Ndarja e produkteve didaktike për fëmijë duhet të jetë e organizuar sipas llojit të tyre dhe moshave përkatëse.
13. Duhet të merren masa efektive për dizinfektim të parandaluar hyrjen e brejtësve, insekteve, dhe kafshëve të tjera në bankën ushqimore.

Nëse ka donatorë të cilët duan të ofrojnë produkte ushqimore, ju lutem të mbani kushtet e mëposhtme në vëmendje:

1. Paketimi duhet të jetë i mbyllur dhe i paprekur.
2. Sigurohuni që të gjitha ushqimet të jenë brenda datës së skadencës.
3. Lutemi të keni parasysh se banka ushqimore nuk ka frigoriferë. Si rezultat, nuk mund të pranohen ushqime që duhet të mbahen në frigorifer.
4. Nëse dhurohen veshmbathje, nga ekipi i SHMFF duhet të sigurohet larja e tyre përpara vendosjes në magazinë.
5. Për magazinimin e mallrave të dhuruar ndiqen të gjitha procedurat sipas protokolleve përkatëse të Bashkisë Korçë.

Disa shembuj të ushqimeve dhe furnizimeve që mund t'i dhurohen Bankës së SHMFF janë:

1. Ushqimore

- miell dhe produkte të tjera të drithërave
- vaj gatimi, sheqer, kripë, salcë
- ushqime të ndryshme të konservuara
- oriz, fasule, makarona
- qumësht pluhur
- ushqime për nënat shtatzëna dhe foshnjat
- ushqime për njerëzit me diabet
- peshku i konservuar
- çokollatë, biskota
- marmelatë, reçel, krem çokollatë, mjaltë
- çaj, kafe dhe kakao
- lëngje dhe pije me gaz

2. Veshmbathje

- Rroba për fëmijë dhe të rritur;



BASHKIA KORÇË

- Këpucë për fëmijë dhe të rritur;
- Batanije, çarçaf, jorgan;
- Peshqira;
- Të brendshme si mbathje, kanotjere etj.

3. Mjete didaktike për fëmijë

- Stilolapsa/lapsa/lapsa me ngjyra/bojëra me ngjyra;
- Vizore/kompas/raportor;
- Fletore matematike dhe shkrimi;
- Libra për fëmijë;
- Libra për të rritur;
- Çanta shkolle; ▪ Çanta kopshti etj.

SHMFF gjithashtu pranon donacione të furnizimeve shtëpiake të tilla si produkte pastrimi dhe higjienë personale. Disa shembuj të artikujve të pranueshëm janë:

- pastë dhëmbësh dhe furçë dhëmbësh;
- sapunë, shampo;
- detergjentë të ndryshëm për rroba, pllaka, enë;
- paketa të kujdesit vetjak për fëmijë, të rritur, gra dhe burra (peceta mujore dhe ditore për gra, mjete rroje, pelena për fëmijë dhe të rritur etj);

NË VËMENDJE TË STAFIT PËRGJEGJËS:

1. Pastrimi dhe dezinfektimi periodik i mjediseve të punës

SHMFF garanton pastrimin e përditshëm dhe dezinfektimin periodik të mjediseve kryesore të përzgjedhura për magazinimin e bankës ushqimore, veshmbathje, higjenosanitare duke ndjekur dhe respektuar procedurat me drejtorinë përkatëse në Bashkinë Korçë.

2. Sanksionet për shkeljet e masave organizative

Mosrespektimi apo neglizhimi i masave të veçanta në këtë dokument në lidhje me kushtet higjenosanitare gjatë procesit të magazinimit, paketimit, sistemimit dhe transportimit të produkteve përbën shkak për fillimin e ecurisë disiplinore për shkelje apo procedurës për zgjidhje të menjëhershme për shkaqe të arsyeshme të kontratës së punës.